



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **19.4.2023**, me fillim në ora **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **zt. Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, Nënkryetarin **Fatmir Iska**, drejtorët e drejtorive. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të KFOR-it, zyrtarë komunalë, të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P- 71510057-02240-1, zona kadastrale - Rahovec;
3. Shqyrtimi i propozimvendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022 në 2023;
4. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01Nr 352/3 i datës 09.04.1986 mbi rivlerësimin dhe rikategorizimin e zonës së mbrojtur të “Kanioni i Drinit të Bardhë”;
5. Shqyrtimi i raportit tre - mujor financiar, janar - mars 2023;
6. Shqyrtimi i raportit financiar buxhetor i NPL – Stacioni i Autobusëve – Rahovec;
7. Shqyrtimi i raportit të punës tre - mujore të KRM – Ekoregjonit;
8. Shqyrtimi i planit komunal të veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Rahovecit;
9. Të ndryshme.

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë sugjerim, propozim apo pikë shtesë rreth rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim miratimin e rendit të ditës. Kush është “për”?... Me shumicë votash, miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë sugjerim apo ndonjë vërejtje rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash, miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P- 71510057-02240-1, zona kadastrale - Rahovec;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së, para jush e keni propozimin e kryetarit të komunës për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës 02240-1, zona kadastrale – Rahovec, sipërfaqja e kësaj parcele është shumë më e madhe (2 ha) sesa ajo që ne kërkojmë ta shpallim me interes të

përgjithshëm. Qëllimi i shpalljes është këmbimi i pronës me agjencionin pyjor, konkretisht parcela gjendet te Maja e Shkodranit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i propozimvendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022 në 2023;

Afrim Limani – Përshëndetje kryesues, anëtarë të KPF-së. Kjo pikë në seancën e muajin shkurt ka kaluar, mirëpo, me 5 prill, adresën time ka ardhë në email, që bartja e të hyrave vetanake nuk mund të procesohet më tutje sepse sipas ligjit të buxhetit të vitit 2023, shuma e mjeteve nga kodi i të hyrave vetanake nuk mund të bartet. Ne jemi detyruar që edhe një herë ta rikthejmë këtë pikë në kuvend duke e ndryshuar strukturën e projektit. Shuma totale që nuk mund të bartet më tutje e që shkon në suficit është 58.267 euro, nga totali që është 479.989. Në fund shuma e bartur ngelet 421.722 euro. Projektet e propozuara mbesim, mirëpo, vlerën prej 58.267 jemi detyruar ta zbresim.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush ndonjë koment rreth bartjes së mjeteve?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i plotësimit ndryshimit të vendimit 01Nr 352/3 i datës 09.04.1986 mbi rivlerësimin dhe rikategorizimin e zonës së mbrojtur të “Kanioni i Drinit të Bardhë”;

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtarë të KPF-së, bëhet fjalë për një vendim shumë të rëndësishëm që i prek dy zona kadastrale, Xërren dhe Gexhën. Në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, jemi kujdesur për ta dorëzuar fizikisht vendimin i cili është ala në fuqi (vendim i vitit 1986) që konkretisht, kanë qenë në mbrojtje këto dy zona. Pas studimit të pronës nga ministria, e kanë dorëzuar një propozim profesional që ka të bëjë me rikategorizim të monumenteve të natyrës, duke u bazuar në ligjin për mbrojtjen e natyrës. Pra, para jush është vendimi për dhënien në mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejt, si monument natyror. Do të kujdesemi që para seancës së kuvendit, t’ju dorëzojmë edhe një njoftim tjetër më të detajizuar.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush ndonjë koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e katërt e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i raportit tre - mujor financiar, janar - mars 2023;

Afrim Limani – Drejtorja për Buxhet dhe Financa ka arritur që me kohë ta përgatis këtë raport 3 mujor financiar edhe pse janë disa data që vonohen për shkak të barazimit me Ministrinë e Financave. Ky raport përbëhet nga dy pjesë, pjesa e të hyrave dhe pjesa e shpenzimeve. Të hyrat e rregullta për këtë 3 mujor kanë qenë 358.958 euro dhe nëse e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi diferencë pozitive prej 103.627 euro. Shpenzimi i buxhetit për këtë 3 mujor është shpenzuar 25.27% ose 4.436.442 euro, prej tyre 23.17% janë investime kapitale, subvencione 16.17%, komunal 31.38 %, mallra dhe shërbime 21.66%, paga dhe mëditje 26.32%.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e pestë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i raportit financiar buxhetor i NPL – Stacioni i Autobusëve – Rahovec;

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë anëtarët, përshëndetje për KFOR-in dhe zyrtarët nga OSBE. Unë jam në cilësinë e komisionit komunal të aksionerëve, jam në dy komisione: Në komisionin për stacionin e autobusave dhe në atë të ndërmarrjes publike-lokale dhe regjionale KRM Ekoregjon. Nuk do të flasë shumë rreth kësaj teme, por nëse e shihni të arsyeshme që komisioni komunal i aksionerëve të raportojë në mbledhje të kuvendit apo ndonjë anëtarë i bordit, varet se si e kërkon ju.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Besoj që komisioni i aksionerëve duhet të raportojë në seancën e rregullt të kuvendit. Atëherë edhe pika e shtatë është e njëjta temë që u diskutua.

7. Shqyrtimi i raportit të punës tre - mujore të KRM – Ekoregjonit;

Kryesuesi – Po i vendosim në votim të dy pikat bashkë (7 dhe 8)! Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pikat gjashtë dhe shtatë.

8. Shqyrtimi i planit komunal të veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Rahovecit;

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtorë, zyrtarë të KFOR-it, anëtarë të KPF-së. Qeveria e republikës së Kosovës ka aprovuar Strategjinë e Migrimit 2021-2025 dhe Rregulloren 22-2020 që ka të bëjë kryesisht rreth integritet të personave të riatdhesuar dhe rregulloren për integrimin e të huajve. Poashtu ka hartuar edhe një strategji që do të zbatohet në komunat respektive të Kosovës. Është shtuar edhe komponenta e “të huajve” dhe në bashkëpunim me ministrinë e punëve të brendshme do ta gjejmë një modalitet për zgjerimin e kapaciteteve tona edhe në resurse humane.

Kryesuesi – Faleminderit Lendrit. A ka dikush ndonjë pyetje, koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet e tetë e rendit të ditës.

9. Të ndryshme;

Kryesuesi – Nëse dikush prej anëtarëve të KPF-së ka ndonjë çështje apo diskutim për ta ngritur?... Nëse jo, atëherë me këtë pike po përfundon rendi i ditës për sot, por, në fund i kemi edhe dy propozime tjera, dy pika shtesë për rendin e ditës për seancën e rregullt.

Erhan Morina – Faleminderit kryesues! Të nderuar të pranishëm, propozoj që për seancën e rregullt të futet në rend dite shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim përmes shprehjes së interes të P- 00266-0 të Fabrikës së Kartanit në zonën kadastrale Hoçë e Madhe;

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim këtë propozim, kush është “për”?... Me shumicë votash, përfshihet edhe kjo pikë në rend të ditës për në seancën e rregullt të prillit. E kemi edhe një propozim tjetër nga Komiteti për Shëndetësi: **Vendimi për aprovimin e Planit të Veprimit të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale**; Kush është “për” përfshierjen edhe të kësaj pike në rend dite për në seancën e rregullt të kuvendit?... Me shumicë votash aprovohet edhe kjo pikë. Shihemi në seancë.

Mbledhja përfundoi në ora 10:40

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

